

RELACION

Mbi Projektligjin **PËR STATUSIN E MINATORIT(PUNONJËSVE TË MINIERAVE NË NËNTOKË)**

Projektligji “Për statusin e minatorit (punonjësve të minierave në nëntokë)” pajis punonjësit dhe ish-punonjësit e minierave të nëntokës me mbrojtjen ligjore, aq shumë të munguar dhe kërkuar prej tyre në vijimësi.

Punonjësit e sektorit të minierave, pas ndryshimeve strukturore të sektorit në vitet 1992-1993, në një masë të madhe dolën të papunë. Numri përlllogaritet në rreth 40.000 ish-punonjës. Përveç kësaj, punonjësit e minierave të qymyrit, kromit, bakrit, hekur-nikelit dhe boksiteve etj, u gjendën të pambrojtur përballë reformave drastike dhe mbylljes masive të minierave të kohës.

Në këtë pikë asnjë masë shtetërore nuk u ndërmor për rikualifikimin e tyre e për riintegrimin e minatorëve të deridjeshëm në kushtet e krijuara rishtas. Shtuar kësaj të dhëne edhe moshën, shëndetin e rënduar, kualifikimin e papërshtatshëm për sektorë të tjerë, shumë prej ish-minatorëve u privuan nga tregu i punës

Në piramidën e pagave/pensioneve kontributi i pashembullt i punonjësve të sektorit më prodhimtar për ekonominë e vendit për dekada të tëra është i papërkueshëm dhe në disproporcion me çfarë atyre u jepet.

Gjithashtu, indeksimi vit pas viti i pensioneve, ka qenë dukshëm më pak sesa duhej, çka reflektohet sot në faktin se një pensionist nëntoke i dalë në pension para viteve 93-96 nga reformat, merr sot një pension më të vogël sesa nënpunës të sektoreve shumë më pak impenjativ, e aspak prodhimtarë e kontribues në ekonominë e vendit.

Në të shkuarën njihen edhe masa të papëlqyera e që rënduan kategorinë e minatorëve, si miratimi i rritjes së moshës së pensionit për minatorët nga 50 në 65 vjeç, gabim që, fatmirësisht, u korigjua nëpërmjet ligjit Nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë,” duke vendosur kufirin e arsyeshëm prej 55 vjeç.

Ky projektligj sjell përshkallëzimin e moshës së daljes në pension.

Situata e tanishme përsillet rreth një nonsens, human dhe ligjor p.sh.:

Pranojmë se minatori që ka realizuar 12.5 vite nëntokë dhe 30 vite pune gjithsej del në pension 55 vjeç, ndërsa ai që ka punuar 12, ose 11.5, ose 11, ose 10.5, ose 10 vite nëntokë etj. mund të dalë vetëm 10 vjet në moshë më të shtyrë, pra 65 vjeç.

Ky projektligj sjell uljen e kufirit të vjetërsisë për të dalët në papunësi nga reformat e sipërpërmendura. Ky projektligj ul kufirin e vjetërsisë së punës nga 30 vitë në 23 vjet për ish-punonjësit e nxjerrë të papunë nga reformat.

Kjo gjen bazë edhe në ligjin nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”.

Ky projektligj sjell pagën minmale të nëntokës sot, më e pakta 175 % të pagës minimale zyrtare.

Ky projektligj sjell pensionin e nëntokës sot, më e paktë 131% të pagës minimale zyrtare dhe shërbim shëndetësor falas.

Projektligji gjen shembuj mbështetës te statusi i sapomiratur i ish-naftëtarëve dhe në modele të tjera ekzistuese:

1. Ligj nr. 9210, dt. 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
2. Ligj nr. 9418, dt. 20.05.2005 “Për Sigurimin Shoqëror Suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9481, dt. 16.02.2006.
3. Ligj nr. 9361, dt. 24.03.2005 “Për një Trajtim të Veçantë Financiar të Efektivave, Oficerë dhe Nënoficerë Lundrues, të Nëndetseve dhe Polumbarëve të Forcate Detare në Pension”.
4. Ligj nr.9128, dt. 29.07.2003 “Për një Trajtim të Veçantë të Pilotëve Fluturues në Pension”.

Projektligji është i mbështetur në Kushtetutë dhe ka efekt financiar të përballueshëm nga buxheti i shtetit.

Përparim Spahiu
Deputet i LSI